

VENDIM
Nr.592, datë 14.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA FIERSHEGAN, TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Fiershegan, të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 1 (një), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Fiershegan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2.FORMULARI PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Mbeshtetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj)

Institucioni i Pushtetit Qendror: Ministria e Mjedisit, pyjeve dhe Administrimit të Ujërave										
Komuna: Fiershegan										
Fusha e përdorimit të pronës: Pyll										
Nr rend.	Nr. inven	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës.	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësit administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	184	Ek. P. Balaj-Mollas	Mali i Kosovës	14/a	Lëndë punimi, dru zjarri	11	Prodhues	M.M.P.A.U	D.SH.P	

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Fiershegan

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
184	Pyll	Në pronësi